

Në bazë të nenit 12 al. 2, pika c, nenit 40 al.2, pika b, dhe nenit 24 al.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1, nenit 77 al.1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shtator 2010, mori këtë:

VENDIM
PËR BUXHETIN FINAL TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2011
DHE VITET 2011-2013

Neni 1

Miratohet parashikimi i të hyrave dhe i shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2011 dhe 2011-2013, i cili do të jetë si vijon:

1.
Për vitin 2011

Të hyrat vetjake të komunës që pritet të realizohen:

- Nga Administrata Lokale.....	4.921.830.00 euro
Të hyrat vetjake të arsimit	0.00 euro
Të hyrat vetjake të shëndetësisë	200.000.00 euro
SUBTOTALI	5.121.830.00 euro

- Nga granti qeveritar që pritet të realizohen:	
Granti i përgjithshëm qeveritar	10.268.847.00 euro
Granti për arsim	9.393.862.00 euro
Granti për shëndetësi	3.237.956.00 euro
Subtotali	22.900.665.00 euro

TË HYRAT TOTALE **28.022.495,00 euro**

Shpenzimet që parashikohen të orientohen:

- Për rrogat-pagat dhe mëditjet për të gjitha njësitë buxhetore	
Subtotali	10.988.966.00 euro

- Për mallra dhe shërbime për të gjitha njësitë buxhetore komunale	
Subtotali	2.076.942.00 euro

- Për shërbime komunale për të gjitha njësitë buxhetore	
Subtotali	660.032.00 euro

- Për subvencione - për të gjitha njësitë buxhetore	360.979.00 euro
- Për investime kapitale që parashikohen të orientohen për të gjitha njësitë buxhetore	
Subtotali	13.935.576.00 euro
T O T A L I	28.022.495,00 euro

2. Për vitin 2012

Të hyrat vetjake të komunës që pritet të realizohen:

- Nga Administrata Lokale.....	5.069.575.00 euro
- Të hyrat vetjake të arsimit	0.00 euro
- Të hyrat vetjake të shëndetësisë	200.000 euro
SUBTOTALI	5.269.575.00 euro

Nga granti qeveritar që pritet të realizohen:

- Granti i përgjithshëm qeveritar	11.377.196.00 euro
- Granti për arsim	9.393.862.00 euro
Granti për shëndetësi	3.237.956.00 euro
Subtotali	24.009.014.00 euro

TË HYRAT TOTALE **29.278.589.00 euro**

Shpenzimet që parashikohen të orientohen:

- Për rrogat - pagat dhe mëditjet për të gjitha njësitë buxhetore	
Subtotali	10.988.966.00 euro
- Për mallra dhe shërbime për të gjitha njësitë buxhetore komunale	
Subtotali	2.076.942.00 euro
- Për shërbime komunale për të gjitha njësitë buxhetore	

Subtotali	660.032.00 euro
- Për subvencione për të gjitha njësitë buxhetore	360.979.00 euro
- Për investime kapitale që parashikohen të orientohen për të gjitha njësitë buxhetore	
Subtotali	15.191.670.00 euro
T O T A L I	29.278.589.00 euro

3. Për vitin 2013

Të hyrat vetjake të komunës që pritet të realizohen:

- Nga Administrata Lokale.....	5.205.291.00 euro
Të hyrat vetjake të arsimit	0.00 euro
Të hyrat vetjake të shëndetësisë	200.000.00 euro
SUBTOTALI	5.405.291.00 euro
- Nga Granti qeveritar që pritet të realizohen:	
Granti i përgjithshëm qeveritar	12.564.810.00 euro
Granti për arsim	9.393.862.00 euro
Granti për shëndetësi	3.237.956.00 euro
Subtotali	25.196.628.00 euro
TË HYRAT TOTALE	30.601.919.00 euro

Shpenzimet që parashikohen të orientohen:

- Për rrogat - pagat dhe mëditjet për të gjitha njësitë buxhetore	
Subtotali	10.988.966.00 euro
- Për mallra dhe shërbime për të gjitha njësitë buxhetore komunale	
Subtotali	2.076.942.00 euro
- Për shërbime komunale për të gjitha njësitë buxhetore	
Subtotali	660.032.00 euro

- Për subvencione për të gjitha njësitë buxhetore **360.979.00 euro**
- Për investime kapitale që parashikohen të orientohen për të gjitha njësitë buxhetore
- Subtotali**16.515.000,00 euro**

T O T A L I 30.601.919.00 euro

Neni 2

Të hyrat dhe shpenzimet e parapara në nenin 1 të këtij Vendimi, për të gjitha kategoritë buxhetore në mënyrë detaje janë të parapara në buxhetin final të Komunës së Prizrenit për vitin 2011 dhe vitet 2011-2013, që është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimit do të kujdeset kryetari i Komunës.
Realizimi dhe zbatimi i këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat dhe ligjet në fuqi dhe udhëzimet e tjera që e rregullojnë këtë çështje dhe rregullat e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar

Neni 4

Me këtë Vendim do të njoftohet Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Kosovës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-4983
Më 23 shtator 2010
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 12 al. 2, pika c, nenit 40 al.2, pika b, dhe nenit 24 al.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1, nenit 77 al.1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shtator 2010, mori këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN E BUXHETI FINAL TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR
VITIN 2011

Neni 1

Duke u bazuar në Memorandumin e nënshkruar nga ana e MASHT dhe MEF, me këtë Vendim bëhet ndryshimi i pjesshëm i parashikimeve të të hyrave dhe të shpenzimeve të parashikuara me nenin 1 të Vendimit rreth miratimit të buxhetit të Komunës për vitin 2011 nr. 01/011-4983, të datës 23 shtator 2010, kështu që në kuadër të buxhetit ndryshohen parashikimet e parapara të të hyrave dhe shpenzimeve totale, që do të jenë: Të hyrat e parashikuara në shumën prej **28.022.495,00 euro, do të jenë 28.222.495,00 euro.**

- Pozicioni i paraparë në të hyrat vetjake të arsimit, i cili ka qenë i paraparë në shumën prej 0,00 euro, parashikohet të jetë **200.000 euro** dhe kjo shumë bartet: Në pozicionin për pagat e arsimit në shumën prej 108.000 euro, ashtu që shuma e parashikuar për këtë qëllim 7.661.318,00 euro, ndryshohet dhe do të jetë 7.763.318,00 euro, gjersa shuma prej 92.000 euro, bartet në pozicionin për mallra dhe shërbime në arsim, ashtu që shuma e parashikuar për këtë qëllim ndryshohet dhe, në vend të shumës së parashikuar prej **863.500 euro**, parashikohet të jetë shuma prej **961.500 euro.**

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimit do të kujdeset kryetari i Komunës.

Realizimi dhe zbatimi i këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat dhe ligjet në fuqi, si dhe udhëzimeve të tjera që e rregullojnë këtë çështje dhe rregullat e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohet Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Kosovës.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-4992
Më 23 shtator 2010
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 12 al. 2, pika c, nenit 40 al.2, pika b, dhe nenit 24 al.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1, nenit 77 al.1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shtator 2010, mori këtë:

VENDIM
PËR RIDESTINIM TË MJETEVE TË MBETURA NË BUXHETIN E KOMUNËS
SË PRIZRENIT NGA INVESTIMET KAPITALE

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet ridestinimi i mjeteve të Buxhetit të Komunës për vitin 2010, të parapara për investime kapitale të mbetura gjatë realizimit të projekteve në lartësi prej 98.614 euro në kategorinë e pagave të shërbyesve civilë të Komunës së Prizrenit, me qëllim të stimulimit të shërbyesve civilë, mjetet e mbetura janë nga projektet nëpër drejtorit, si në vijim:

I Nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - projekti dhe kodi

- a. “Zgjerimi, rrafshimi dhe rregullimi i rrugëve fushore” - kodi 80493, vlera e planifikuar është 20.000 €, vlera e kontratës është 13.000 €, ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 7.000 €.
- b. “Përkrahja e bletarëve në mjete mbrojtëse” - kodi 80504, vlera e planifikuar është 6500 €, vlera e kontratës është 0.00 € dhe mbetja nga ky projekt është 6.500 €.
- c. “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i qytetit”- kodi 80505, vlera e planifikuar është 30.000 €, vlera e kontratës është 22.747 €, ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 7.253 €.
- d. “Ndërtimi i kanalit të ujitjes së tokave bujqësore- S. e Ulët” - kodi 80506, vlera e planifikuar është 10.000 €, vlera e kontratës është 7.781 €, ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 2.219 €.
- e. “Ndërtimi i kanalit të ujitjes së tokave bujqësore- Lubizhdë” - kodi 80507, vlera e planifikuar është 8.500 €, vlera e kontratës është 5.988 € , ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 2.512 €.
- f. “Ndërtimi i pendës-digës për ujitje-Smaq” - kodi 80509, vlera e planifikuar është 30.000 €, vlera e kontratës është 24.005 € , ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 5.995 €.
- g. “Parandalimi i sëmundjeve në blegtori” - kodi 80503, vlera e planifikuar është 10.000 €, vlera e kontratës është 9.700 €, ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 300 €.

II Nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - projekti dhe kodi

“Renovimi i Qendrës Rinore në Ortakoll”, kodi 80537, vlera e planifikuar është 25.000 €, vlera e kontratës është 18.165 €, ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 6.835 €.

III Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike - projekti dhe kodi

- a. “Ndërtimi i rrugës në Tusuz”, kodi 80440, vlera e planifikuar është 80.000 €, vlera e kontratës është 50.000 €, ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 30.000 €.
- b. “Ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në Tupec”, kodi 80447, vlera e planifikuar është 100.000 €, vlera e kontratës është 70.000 €, ndërkaq, mbetja nga ky projekt është 30.000 €.

Neni 2

Shuma e përgjithshme e mjeteve, të cilat konsiderohen si mjete të mbetura nga projektet e sipërpërmendura në lartësi prej 98.614 € të ridestinuara në kategorinë e pagave të shërbyesve civilë të Komunës së Prizrenit, do të shërbejnë me qëllim të stimulimit të shërbyesve civilë. Secili shërbyes civil i Shërbimit Civil të Komunës së Prizrenit, nga këto mjete do të stimulohet me nga 44 euro neto për çdo muaj, duke filluar që nga data 1 korrik 2010 deri më 31 dhjetor 2010.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimit do të kujdesen: kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe të gjitha drejtoritë e tjera komunale.

Realizimi dhe zbatimi i këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat dhe ligjet në fuqi, si dhe me udhëzimet e tjera që e rregullojnë këtë çështje dhe rregullat e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohen: Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Kosovës, kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe të gjithë drejtoritë e tjera komunale.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-5151
Më 23 shtator 2010, Prizren

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 12 al. 2, pika c, nenit 40 al.2, pika b, dhe nenit 24 al.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1, nenit 77 al.1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shtator 2010, mori këtë:

VENDIM
PËR RIDESTINIMIN E MJETEVE PER PROJEKTET KAPITALE 2010

Neni 1

Me këtë vendim lejohet ridestnimi i mjeteve të lejuara për realizimin e Projektit kapital “Ndërtimi i monumentit të Natos”(kodi i projektit **81577**) i aprovuar me Rishikim të buxhetit 2010, vlera e të cilit projekti ka qenë i parashikuar në shumën prej 20.000 euro, tani parashikohet të jetë **15.000 euro**.

Neni 2

Mjetet e ridestinuara për realizimin e projektit nga neni 1 i këtij Vendimi, në lartësi prej 5.000 euro, ridestinohen me qëllim të realizimit të projektin “Projektet e vogla për nevoja të Komunës”(kodi i projektit **80516**) dhe shuma e parashikuar për realizimin e këtij projekti në vend të parashikimit që ka qenë 64.000 euro, tani do të jetë 69.000 euro.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimit do të kujdesen: kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe të gjitha drejtoritë e tjera komunale.

Realizimi dhe zbatimi i këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat dhe ligjet në fuqi, si dhe me udhëzimet e tjera që e rregullojnë këtë çështje dhe rregullat e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar.

Neni 4

Me këtë Vendim do të njoftohen: kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe të gjitha drejtoritë e tjera komunale.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011-5152

Më 23 shtator 2010

P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 12 al. 2, pika c, nenit 40 al.2, pika b, dhe nenit 24 al.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1, nenit 77 al.1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shtator 2010, mori këtë:

**VENDIM
PËR BARTJEN E MJETEVE TË TË HYRAVE VETANAKE**

Neni 1

Me këtë Vendim, duke u bazuar në Memorandumin e nënshkruar nga ana e MASHT dhe MEF, **LEJOHET** bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga MASHT në lartësi prej **3.050,18 euro** (mjete keto të mbledhura përmes shkollave të mesme profesionale të Prizrenit gjatë vitit 2009) në buxhetin e Komunës - pozicioni i pagave në Drejtorinë e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimit do të kujdesen: kryetari i Komunës, Drejtorja për Ekonomi dhe Financa dhe Drejtorja për Arsim dhe Shkencë.

Realizimi dhe zbatimi i këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat dhe ligjet në fuqi, si dhe me udhëzimet e tjera që e rregullojnë këtë çështje dhe rregullat e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohen: kryetari i Komunës, Drejtorja për Ekonomi dhe Financa dhe Drejtorja për Arsim dhe Shkencë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-5153
Më 23 shtator 2010
P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

Në bazë të nenit 12 al. 2, pika c, nenit 40 al.2, pika b, dhe nenit 24 al.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 al. 1, nenit 77 al.1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23 shtator 2010, mori këtë:

V E N D I M
PËR RRRITJEN E TË HYRAVE VETANAKE DHE SHPËRNDARJEN E TYRE

Neni 1

Duke u bazuar në Memorandumin e nënshkruar nga ana e MASHT dhe MEF, me këtë Vendim bëhet ndryshimi i pjesshëm i parashikimeve të të hyrave të parashikuara me nenin 1 të Vendimit rreth miratimit të buxhetit të Komunës për vitin 2010 nr. 01/011-6126, të datës 30 shtator 2009, kështu që në kuadër të buxhetit ndryshohen parashikimet e parapara të të hyrave, ashtu që rriten për **150.000,00, euro** dhe do të jenë në vend të parashikimit prej **4.964,235,00 euro**, parashikohet të jenë **5.114.235.00 euro**.

Diferenca ndërmjet planifikimit dhe realizimit të të hyrave vetanake është në shumën **150.000 €**.

Neni 2

Diferenca e përshkruar (**rritja prej 150.000,00 euro**) në nenin 1 të këtij Vendimi, orientohet për:

- Paga dhe mëditje - shuma prej **70.000 euro** dhe
- Mallra e shërbime - shuma prej **80.000 euro**.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimit do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe Drejtoria për Arsim dhe Shkencë.

Realizimi dhe zbatimi i këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat dhe ligjet në fuqi dhe udhëzimeve të tjera që e rregullojnë këtë çështje dhe rregullat e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa dhe Drejtoria për Arsim dhe Shkencë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-5154
Më 23 shtator 2010, P r i z r e n

Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu

This document was created with Win2PDF available at <http://www.daneprairie.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.